



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 8361 Prot.

Date 18/03/2024

NJOFTIM

“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E RREGULLORËS PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE NË BASHKINË LEZHË”

Bashkia Lezhë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit” (i ndryshuar), në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar; në Ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiterozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, vendimin nr. 1096, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, me qëllim shfrytëzimin në mënyrë të unifikuar të hapësirave publike në Bashkinë e Lezhës dhe krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit, ka hartuar rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike në Bashkinë Lezhë.

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e martë datë 23.04.2024 ora 10:00, në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Lezhë. Gjatë takimit të dëgjesës publike do të bëhet prezantimi i projekt vendimit për “Miratimin e rregullorës për shfrytëzimin e hapësirave publike në Bashkinë Lezhë”.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja!



KRYETARI
Pjerin NDREU